



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-Gjiçan shpall:
Thirrje publike për mbështetje financiare për OJQ në Komunën e Gjiçanit

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së thirrjes: 12.03.2025
Afati i fundit për aplikim: 01.04.2025

Mars, 2025

Përmbajtja

1. Hyrje	2
2. Si të aplikoni	2
2.1 Dokumentacioni i detyrueshëm për OJQ	2
2.3 Ku ta dorëzoni aplikacionin	4
2.4 Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve	4
2.5 Aktivitetet e pranueshme që do financohen përmes thirrjes publike.....	4
2.6 Aktivitetet e pa pranueshme që nuk financohen përmes thirrjes publike.....	4
2.7 Shpenzimet e drejtëpërdrejta të pranueshme përmes thirrjes publike.....	5
2.8 Shpenzimet e pa pranueshme.....	5
3. Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi.....	6
4. Kalendari tregues.....	7
5. Lista e dokumenteve të thirrjes publike.....	7&8

1. Hyrje

Rregullorja për Kriteret Standardet dhe Procedurat e financimit publik për OJQ-të në Nenin 14 ka paraparë edhe përgatitjen e udhëzimeve të thirrjes për Aplikantët për paraqitjen e informacionit mbi objektivat e thirrjes publike, kushtet e thirrjes, mënyrën e aplikimit dhe zbatimit të procedurës së thirrjes dhe përzgjedhjes së përfituesve. Udhëzimet për aplikuesit kanë për qëllim të japin një pasqyrë të plotë të qëllimit të hapjes së thirrjes publike. Aplikuesi duhet të analizojë në mënyrë të plotë thirrjen publike dhe këtë udhëzim për aplikim për të krijuar një pasqyrë mbi qëllimin e ofruesit të mbështetjes financiare me rastin e hapjes së thirrjes publike.

Sa i përket procesit të pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënies së fondeve, kohës dhe mënyrës së parashtrimit të ankesave, trajtimit të dokumenteve dhe kalendarit tregues të zbatimit të thirrjes, lexoni udhëzimet këtu: Rregullore MF – Nr. - 04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve

2. Si të aplikoni?

Aplikimi i OJQ-ve konsiderohet i plotë, nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në paragrafin 2.1 përkatësisht 2.2 dhe dorëzohen siç kërkohet në paragrafin 2.3 nga ky udhëzim.

2.1 Dokumentacioni i detyrueshëm për OJQ

1. Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së;
2. Çertifikata e Nr. Fiskal të OJQ-së;

3. Vërtetimi/ konfirmimi bankar i OJQ-së;
4. Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të OJQ-së;
5. Aplikacioni për projekt;
6. Forma e buxhetit;
7. Deklarata mbi financimin e dyfishtë për OJQ;
8. Deklarata e partneritetit për OJQ;
9. Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin paraprak;

Shkarko, dhe plotëso me kompjuter, dokumentacionin (Aplikacioni për projekt, forma e buxhetit, deklarata mbi financimin e dyfishtë, deklarata e partneritetit, deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin paraprak) të cilat janë publikuar në kuadër të kësaj thirrje.

2.2 Ku ta dorëzoni dokumentacionin:

- Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Për individët, kërkohet vetëm nënshkrimi.
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në kopje fizike, në adresën e mëposhtme:
- Aplikimi origjinal, duhet të dorëzohet në Qendrën për shërbime me qytetarë, ndërtesa e Soliterit, kati I. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i plotë i aplikuesit me shënimin: ***“Të mos hapet para takimit të Komisionit Vlerësues”***.

2.3 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga data: 12.03.2025 deri më 01.04.2025.

2.4 Aktivitetet e pranueshme që do financohen përmes thirjes publike

Aktivitetet e pranueshme të projektit mund të përfshijnë:

1. Kërkesat nga Klubet Sportive;
2. Kërkesat nga OJQ-të;
3. Kërkesat nga Shoqatat;

2.5 Aktivitetet e pa pranueshme që nuk financohen përmes thirjes publike

1. Aktivitete që përmbajnë diskriminim gjinor;
2. Aktivitete që përmbajnë diskriminim fetar;
3. Aktivitetet të cilat përmbajnë promovim të gjuhës së urrejtjes;
4. Aktivitetet të cilat përmbajnë nxitje të ekstremizmit të dhunshëm.

2.6 Shpenzimet e drejtëpërdrejta të pranueshme përmes thirrjes publike

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e aktiviteteve të projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

1. Shpenzimet rreth organizimit të aktiviteteve;
2. Material shpenzues;
3. Sigurimi i sallave, shpenzimet e zërimit, ndriçimit;
4. Transporti
5. Pjesëmarrjen në gara vendore, ndërkombëtare, pjesëmarrje në turne,
6. Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit),
7. Shërbime grafike (shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, duke specifikuar llojin e qëllimit të shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj;)
8. Kosto të tjera që lidhen drejtëpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit.
9. Pagat

2.7 Shpenzimet e pa pranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

1. Renovime;
2. Dhurata;
3. Shpenzime për blerje të paisjeve;
4. Shpenzime për kompenzime të ndonjë borgji paraprak;

3. Dokumentacioni shpresë dhe kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shpresë kur të aplikoni, DKRS-ja do të kërkojë dokumentacion shpresë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, kanë hyrë në listën e përkohshme të projekteve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, DKRS-ja do të kërkojë shqyrtimin e vijave buxhetore për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara. Linjat buxhetore duhet të nënshkruhen nga përfituesi i projektit dhe zyrtari përgjegjës në DKRS.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shpresë.

Nëse përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shpresë brenda kohës së caktuar, përfituesi do të refuzohet.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për financimin e projekteve.

4. Kalendari tregues

Fazat e procedurës së thirrjes:

- Afati i fundit për aplikimet : 01.04.2025, në ora 16:00.
- Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen : 25.03.2025 në ora 16:00.
- Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen : 25.03.2025, në ora 16:00.
- Afati i fundit për vlerësimin e aplikimeve në mënyrë përmbajtjesore: 15.04.2025, në ora 16:00.
- Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë: 08.04.2025, në ora 16:00.
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar: 11.04.2025, në ora 16:00.
- Afati i fundit për dorëzimin e ankesave: 20.04.2024, në ora 16:00.
- Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi aplikantëve: 30.04.2024, në ora 16:00.

Financuesi ka të drejtë të përditësoj kalendarin indikativ.


6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

FORMULARËT

1. Thirrje publike për mbështetje financiare për OJQ
2. Udhezimet për aplikantët për mbështetje financiare për OJQ
3. Formulari 5A Aplikacion për projekt për OJQ
4. Formulari 6, forma e buxhetit për OJQ;
5. Formulari 7, deklarata mbi financimin e dyfishtë
6. Formulari 8, deklarata e partneritetit;
7. Formulari 9, deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në dy vitet e fundit
8. Kalendari vjetor i Aktiviteteve DKRS 2025

Vërejtje/Kujdes: Të gjitha aplikimet të cilat nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do

të merren parasysh dhe do të diskualifikohen në fazën I- Vlerësimi administrativ.



Drejtori
Kushtrim Zeqiri